



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 173, datë 9.11.2018

PËR

NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR HARTIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR SIGURINË KIBERNETIKE 2019-2025

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2013, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2019-2025.
2. Grupi i punës të drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike dhe në përbërje të tij të ketë përfaqësues nga:
 - Kryeministria;
 - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK);
 - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
 - Ministria e Mbrojtjes;
 - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
 - Shërbimi Informativ i Shtetit;
 - Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

3. Institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, të dërgojnë pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike emrat e përfaqësuesve të tyre, të cilët do të jenë anëtarë të grupit të punës.
4. Me ftesë të kryetarit të grupit ndërinstitucional të punës, në mbledhjet e grupit mund të marrin pjesë edhe përfaqësues nga institucione të tjera, sektori privat si dhe ekspertë ndërkombëtarë të fushës.
5. Në mbledhjen e parë të grupit të punës ngrihet sekretariati teknik, i cili siguron mbështetje teknike dhe logjistike për grupin ndërinstitucional të punës për përgatitjen dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2019-2025.
6. Sekretariati teknik kryen funksionet e mëposhtme:
 - a) Bashkërendon procesin për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2019-2025;
 - b) Ndhmon dhe mbështet grupin ndërinstitucional të punës për përmbushjen e funksioneve të caktuara në këtë urdhër.
7. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit.
8. Ngarkohet grupi ndërinstitucional i punës që, brenda 10 (dhjetë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, të përfundojë hartimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2019-2025.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA